



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2021:092209  
Datë: 26.02.2024  
Numri i dokumentit: 05375440

KPPP.nr.1124/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit NPT “Frutti”, me seli në Reqan, Prizren, me NUI: 810593336, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.K. avokat nga Prizreni, kundër debitorit D.P.T “Durimi”, me seli në fshatin Buzës, Dragash, me NUI: 810289133, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.946/2021 të datës 22.03.2021, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 02.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “D.P.T “Durimi”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.946/2021 të datës 22.03.2021, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë në shumë prej 78 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, me Urdhri Përmbarimor P.nr.946/2021 të datës 22.03.2021, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.549 të datës 25.05.2019, me të cilin e ka urdhëruar që në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij urdhri ta përmbush detyrimin në shumën prej 1,830.00 Euro, me kamatë ligjore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, ka ushtruar prapësim debitori, me të cilin e ka kontestuar në tërësi propozimin për përmbarim, me arsyetimin se i njejtë buron nga fatura e datës 25.05.2019, për të cilën nuk mund të ngarkohet debitori, për shkak se borxhi lëndor nuk ekziston sepse debitori e ka përmbushur në tërësi obligimin që ka pasur ndaj kreditorit. Tutje ka shtuar se debitori i ka paguar atëherë punëtorit të kompanisë “Frutti” (kreditorit), Muso Cufta, shumën prej 1,200.00 Euro, duke qenë se pijet të cilat i ka sjellur ky punëtor nuk ishin sipas kërkesës së debitorit dhe sasia ishte më e madhe sesa ishte porosia, duke i mbetur fillimisht borxh pjesën tjetër të çmimit për mallin e pranuar. Ka theksuar se debitori ka biseduar me punonjësit e kreditorit që shumën prej 1,200.00 Euro e ka paguar tek punëtori i tyre, ndërsa të njejtë e kanë udhëzuar të mos bëjë pagesa të tjera tek ky punëtor. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të refuzohet-hudhet poshtë si i pabazuar propozimi për përmbarim i kreditorit, dhe që shpenzimet kësaj procedure t’i bartë kreditori, duke përfshirë prapësimin dhe shpenzimet e tjera eventuale të cilat do të krijohen.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit se fatura e pranuar së bashku me mallin është shlyer, nuk qëndron fare sepse sikur të ishte paguar si do kërkohej përsëri pagesa, dhe nëse qenka shlyer shuma prej 1,200.00 Euro me para të gatshme, përse paska dashur që të kërkohej kthimi i mallit. Ka shtuar se fatura është dokument përmbarimor sipas nenit 29 të LPP-së, pasi janë të cekura të gjitha detajet e kërkuara, ndërsa pagesa që thirret debitorit nuk është kryer dhe nuk ka asnjë provë të parashtruar në prapësim. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat. I ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale, si dhe për përgjigje në prapësim, sipas pikës 9 të rregullores së tarifave të avokatëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm faturën nr.549 të datës 25.05.2019, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.549 e datës 25.05.2019, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 para. 2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1124/23, me datë 02.02.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.